



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr.
Nr. Dok.

Prot.

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandime lidhur me përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), në Shënkoll, Lezhë.*

Drejtuar: **z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

znj. Nertila KOKA
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP)

LEZHË

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Shënkoll, Lezhë më datë 17.02.2022, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, Komisionerja e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, znj. Ermonela Xhafa, dhe nd/komisionerë z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në IEVP Shënkoll, Lezhë, për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë, u zhvillua në kuadër të vizitave periodike monitoruese për vitin 2022, që zhvillon Mekanizmi Kombëtar (MKPT) pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në institucionet penitenciare.

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtorin e komanduar të institucionit z. Leonard Markdoda dhe specialistin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve z. Sabri Gjeci, të cilët u njohën me qëllimin e inspektimit.

Në takimin me drejtorin e komanduar të institucionit z. Leonard Markdoda, grupi i inspektimit kërkoi fillimisht një informacion lidhur me situatën e respektimit të të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të burgosurve në këtë institucion, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave, gjendjen shëndetësore të stafit dhe të të burgosurve për shkak të sëmundjes infektive COVID-19, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Grupi i inspektimit kërkoi gjithashtu, vënien në dispozicion të kopjeve të praktikave të punës që ndiqen nga sektori juridik, sektori psiko-social, sektori i shërbimit shëndetësor, të organikës së institucionit, si dhe të informacioneve të dërguara Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nga sektori ekonomik dhe ai i burimeve njerëzore, në lidhje me planifikimin e fondeve për përbalimin e situatës të emergjencës dhe nevojën për investime në godinat e banimit në regjimin e brendshëm.

Nga informacioni i marrë¹ u evidentua se, institucioni kishte 5 godina që ndodhen në regjimin e brendshëm, ku nga këto, vetëm godina nr.1 ishte funksionale, në të cilën ishin të akomoduar të paraburgosurit në këtë institucion.

Godinat nr.2 dhe nr.3 për shkak të dëmtimeve në strukturat e jashtme dhe të brendshme të tyre nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, ishin boshatisur nga të gjitha materialet dhe nuk përdorshin për asnjë lloj funksioni. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, godinat duhet të kishin filluar të rikonstrukttoheshin që në janar të vitit 2021, me fondet e qeverisë shqiptare dhe të donatorëve të huaj, të planifikuara për rindërtimin në Qarkun Lezhë, për eliminimin e pasojave të tërmetit, por ende për këto dy godina nuk është bërë asgjë për rikonstrukcionin e tyre edhe pse ka kaluar më shumë se 2 vite.

Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nxitjen e menjëhershme të institucioneve përgjegjëse për gjetjen e fondeve përkatëse, për rikonstrukcionin sa më parë të godinave nr.2 dhe nr.3, në mënyrë që të jenë funksionale për akomodimin e të burgosurve. Gjithashtu, Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kërkon përmirësimin e kushteve për trajtimin e personave të

¹ Drejtori i institucionit të IEVP Shënkoll Lezhë ishte komanduar atë javë.

burgosur, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, në përputhje me aktet ligjore dhe aktet ndërkombëtare në fuqi, si dhe standardet e pranuar ndërkombëtarisht.

Godinat nr.4 dhe nr.5 ishin funksionale, në të cilat ishin akomoduar personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Këto godina ishin vënë në funksion që në muajin nëntor të vitit 2021. Akomodimi i personave në këto godina ishte bërë në bazë të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë për transferimin e shtetasve me masa mjekësore nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë.² Gjithashtu, Godina nr.5, gjatë vitit 2020, kishte shërbyer si spital për të dënuarit dhe të paraburgosurit e sistemit të burgjeve të prekur nga sëmundja infektive COVID-19. Gjatë kësaj periudhe, ishin trajtuar persona të identifikuar me këtë sëmundje, nga institucionet e shëndetit publik të zonave nga ato vinin, të cilët pasi kishin marrë mjekimin e nevojshëm spitalor, kishin rezultuar negativ nga testi i tamponit dhe më pas ishin shpërndarë sipas IEVP-ve respektive ku ata vuanin dënimin.

Ky qëndrim, është i njëjtë me atë të Avokatit të Popullit, i cili ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur nevojën për mbylljen e Institucionit të Veçantë të Zaharisë në Krujë dhe ka kërkuar ngritjen sa më parë të spitalit për këtë kategori të sëmurësh me masë mjekësore "mjekim i detyruar", në IEVP Shënkoll, Lezhë.

Gjatë inspektimit, u konstatua se gjendja aktuale e godinave të parashikuara për spital ishte si më poshtë vijon:

- Godina nr.4, kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin gjithsej të 97 pacientëve me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Aktualisht, kishte përfunduar rikonstruksioni total i godinës, instalimet elektrike dhe ato hidraulike, si dhe shtrimet e pllakave, ishin vendosur dyert e jashtme dhe të brendshme, ishin montuar dritaret, ishte instaluar furnizimi me ujë, instalimi elektrik, instalimi i sistemit të kamerave etj. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe lavamanë. Gjithashtu godina nr. 4 ishte 3 kate, ku në katin e parë ishin 3 dhoma për pacientë dhe pjesa tjetër ishte për stafin shëndetësor. Kati i 2-të dhe 3-të kishin secila nga 12 dhoma, ndër të cilat disa dhoma ishin të pajisura me krevat, dyshek, batanije dhe jastëk, ndërsa të tjerat ishin të pamobiluara. Kapaciteti i secilës dhomë ishte për 3 persona, por për shkak të mbipopullimit që kishte institucioni dhomat ishin të populluara me 5 deri 6 persona. Gjithashtu, në dy godinat ishte kapaciteti maksimal 184 persona. Në ditën e **inspektimit**, në mjediset e institucionit ishin 341 persona, pra me një mbipopullim prej 157 ose 85% personash mbi kapacitetet.
- Godina nr.5 kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, për 87 pacientë. Këto ambiente ishin të pajisura me tualete brenda dhe lavamanë. Gjithashtu, godina nr. 5 ishte 3 kate, ku kati i parë kishte 7 dhoma për pacientë dhe pjesa tjetër ishte për stafin shëndetësor. Kati i 2 dhe i 3-të kishin secili nga 12 dhoma, të pajisura me krevat, dyshek, batanije dhe jastëk. Kapaciteti i secilës

² Urdhëri i Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 03.09.2018 “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, ku është vendosur kalimi në konservim (mbyllje e përkoshëm IEVP Krujë, për shkak të kushteve të papërshtatëshme për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore. Bazuar në plan masash nr. 1240 prot, datë 18.11.2021 “Për transferimin e shtetasve me masë Mjekësor nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë”.

dhomë ishte për 3 persona. Po ashtu edhe në këtë godinë kishte 5 deri 6 persona për çdo dhomë.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, me urdhërin nr.8927/1 datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, klasifikohet “burg i sigurisë të zakonshme”, me një seksion paraburgimi dhe një seksion të veçantë, për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar.

Organika e institucionit përbëhet nga 241 punonjës, prej të cilëve 32 punonjës ishin staf civil dhe 209 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit. Aktualisht organika e IEVP Shënkoll, Lezhë, përbëhet nga sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori ligjor, sektori financiar, sektori i logjistikës, sektori shëndetësor dhe sektori i policisë. Në tërësi organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa.

Konkretisht:

Sektori shëndetësor, përbëhet nga 2 (dy) mjekë të përgjithshëm, njëri me kohë të plotë dhe tjetri part-time, 1(një) kryeinfermier, 6 (gjashtë) infermierë, 1 (një) farmacist dhe 1 (një) stomatolog.

Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, kishte mungesa në pozicionin e drejtorit, zv.drejtorit, të përgjegjësit dhe 1 (një) specialisti të burimeve njerëzore (inxhinier), 2 specialistëve/jurist, 1 (një) elektromekaniku, 1 (një) sek/prot/arshivisti.

Sektori i policisë, kishte mungesa për 2 (dy) punonjës, në pozicionin 1 (një) specialist/policie dhe 1(një) punonjës në rolin bazë në IEVP Shënkoll, Lezhë.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, u evidentua gjithashtu dhe problemi i punonjësve të komanduar nëpër IEVP të tjerë, të 15 punonjësve të policisë dhe 1(një) punonjësi civil, specialist edukimi: konkretisht të komanduar 12 punonjës policie në IEVP Shkodër, 2 punonjës policie në IEVP 313 në Tiranë dhe 1 punonjës civil, specialist edukimi në IEVP “Mine Peza”, Tiranë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ngre si shqetësim komandimet e punonjësve të policisë së burgjeve nëpër IEVP të tjera. Mungesa funksionale e punonjësve të policisë së burgjeve, sipas organikës së miratuar dhe komandimi i tyre në institucionet të tjera të sistemit penitenciar, mund të sjellë pasoja në menaxhimin e sigurt dhe njerëzor të të burgosurve dhe ofrimit të mundësisë së rehabilitimit dhe riintegritit të tyre. Gjithashtu, mos funksionimi i institucionit me kapacitet të plotë sipas strukturës së miratuar, nuk mund të garantojë rendin dhe sigurinë në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale gjatë shoqërimit ose transferimit të të burgosurve, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me legjislacionin në fuqi.

Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë, klasifikohet me një seksion sigurie të zakonshme dhe një seksion paraburgimi me kapacitet maksimal prej 128 **personash**. Në ditën e **inspektimit**, në mjediset e institucionit ishin **162 persona**, ku rezultoi se kishte mbipopullim të paraburgosurve **me 34 persona**, më tepër ose 26% se kapaciteti zyrtar. Ndërsa seksoni i veçantë (për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “mjekim i detyruar”) ishte me kapacitet maksimal 184 persona. Në ditën e **inspektimit**,

në mjediset e institucionit ishin **341 persona**, pra me një mbipopullim prej **157** personash ose 85% mbi kapacitetet.

Sikurse rezultoi nga raportimi, në këtë institucion **kishte mbipopullim konstant për kohë të gjatë mbi kapacitetin fizik** të përcaktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Referuar statistikave, ky institucion ka patur mbipopullim si më poshtë vijon.

- Shtator 161 persona
- Tetor 149 persona
- Nëntor 149 persona
- Dhjetor 150 persona
- Janar 162 persona
- Shkurt 162 persona

Referuar statistikave mbi situatën e popullimit në raport me kapacitetin fizik të institucionit, rezulton se ka patur mbipopullim në masën 26% të kapacitetit përgjatë tërë periudhës 6-mujore.

Në analizën paraprake të kësaj situate, MKPT vlerëson se, si nga inspektimi por dhe për periudhën e lartpërmendur, në I EVP Shënkoll, Lezhë ka patur dhe ka mbipopullim. Rritja e numrit të shtretërve nuk është tregues që përcakton kapacitetin fizik të institucionit, pasi janë cënuar kushtet për jetesë normale të këtyre shtetasve. Konkretisht, në shumicën e dhomave ku ishin akomoduar personat, hapësira dhe sipërfaqja e banimit nuk i përgjigjej parametrave teknike dhe jetësore që i takon çdo personi, sikurse është e miratuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, por edhe larg standardeve ndërkombëtare që synohen të arrihen për këtë qëllim.

Institucioni i Avokatit Popullit çmon se situata e mbipopullimit ka bërë që të akomodohen në përgjithësi 3 dhe 4 persona në dhoma, dhe e konsideron si një problematikë të qenësishme, duke pasur parasysh kapacitetet e lejuara për akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në këtë institucion. Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m² për dhomat për një person dhe 4 m² kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës, sikurse përcaktohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.³

³Vendimi Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo I EVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m3 dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m2 për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”

Godina në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, ishte e papërshtatur për të përballuar kapacitetin maksimal, si dhe dinamikën e lëvizjes të paraburgosurve, që ndryshon pothuajse çdo ditë.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 13.12.2021, informacionit të grumbulluar me drejtorin dhe stafin e institucionit, informacionit dhe evidentimit në vend të kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit, si dhe intervistave konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:⁴

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për përfundimin e punimeve dhe vënien në funksion të godinave nr.4 dhe nr.5, të cilat do të shërbejnë si spital për personat e dënuar me vendim gjykate “mjekim i detyruar” dhe vënien në shërbim për personat e dënuar me vendim gjykate me masën mjekësore “mjekim i detyruar”.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Shënkoll, Lezhë.
3. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një fushe futbollli në ambientet e IEVP Shënkoll, Lezhë për vendosjen e një standardi, argëtues dhe çlodhës për të paraburgosurit në këtë institucion.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtëme:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për rikonstruksionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve, për shkak të gjendjes së amortizuar dhe jashtë kushteve teknike në të cilën ndodhet.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për reduktimin e mbipopullimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) Shënkoll, Lezhë.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për instalimin në godinën e të paraburgosurve të sistemit qëndror për ngrohje/ftohje, si dhe ndërprerjen e lidhjeve të kabllave të rezistencave elektrike që përdoren për ngrohje, pasi përbëjnë rrezik për jetën e të paraburgosurve.

⁴ Të dërguar rekomandimi nr. K4/150-2 datë 13.12.2021 “ Për Përmirësimin e kushteve të trajtimit të të paraburgosurve në IEVP Shenkoll, Lezhë”.

6. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për të siguruar që të gjithë të paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale, në rritjen normative mujore për të plotësuar nevojat personale të tyre, (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
7. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me tavolina, stola, komodina sipas kushteve normale për jetesë, në dhomat e veçimit dhe të observimit, me kushte higjieno-sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në I EVP Shënkoll, Lezhë.
8. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
9. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e organikës të I EVP Shënkoll, Lezhë, konkretisht, të një mjeku me kohë të plotë, 2 (dy) specialist/jurist, 1 (një) elektromekaniku, 1 (një) sek/prot/arshivisti, si dhe plotësimin e sektorit të policisë, me 4 (katër) punonjës në rolin bazë dhe 1 (një) specialist, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas në këtë institucion.
10. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për rritjen e pranisë të punonjësve të sektorit juridik dhe sektorit psiko-social në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.
11. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për eliminimin e plotë të lagështirës në ambientet e kuzhinës, si dhe blerjen e pajisjes për aspirimin dhe ventilimin e ajrit, si dhe lryja dhe mbajtja pastër e këtyre ambiente në I EVP Shënkoll.
12. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, riintegrimi, si edhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive, në bashkëpunim dhe me organizatat jofitimprurëse duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.
13. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi** për verifikimin e urdhërit për kapacitetet e dhomave për personat e dënuar me vendim gjykate me masë mjekësore “mjekim i detyruar” për të bërë të mundur që numri i të burgosurve të garantojë standardin ligjor.

Grupi i inspektimit në vijim të punës, vizitoi mjediset në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë, u njoh me regjistrat dhe dokumentacionin e disa praktikave që kanë të bëjnë me të drejtat e të burgosurve, si dhe zhvilloi intervista në mënyrë konfidenciale me të dënuarit dhe të paraburgosurit në dhomat e tyre.

Në vijim të inspektimit, grupi i punës u njoh me masat e marra për mospërhapjen e infeksionit COVID-19, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e I EVP Shënkoll, Lezhë. Institucioni kishte rregullore të vecantë, ku parashikoheshin masat që duhet të zbatonin punonjësit dhe të paraburgosurit/ burgosurit, për parandalimin e

COVID-19, si dhe në rastet kur evidentoheshin të prekur nga kjo sëmundje. Në hyrje të institucionit, nga punonjësit e informacionit kryhej procedura për matjen e temperaturës me termometër digital për të gjithë personelin dhe personat që hynin për takime me të paraburgosurit apo sillnin pako me ushqime dhe veshmbathje sipas nevojave. Gjithashtu, në hyrje të institucionit ishte vendosur edhe një urë për dezinfektimin e personave që hynin dhe dilnin nga institucioni.

Stafi i administratës dhe stafi i sigurisë që shërbente në regjimin e brendshëm, ishin pajisur me maska mbrojtëse por kishte neglizhencë për vendosjen e tyre, ndërsa në ambiente të aksesueshme për të gjithë stafin, ndodheshin dezinfektantë për pastrimin e duarve. Të paraburgosurit që shoqëroheshin për në spital apo për në seancë gjyqësore në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Lezhë, pajiseshin me maska mbrojtëse.

Ndërsa në ambientet e institucionit dhe në regjimin e brendshëm nuk u vu re të ishin vendosur postera të masave parandaluese të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e protokollit shëndetësor, në kuadër të situatës COVID-19.

Grupi i inspektimit, vlerëson si shqetësuese për situatën që ndodhemi, lagështinë në ambientet e përbashkëta të këtij institucioni, e cila përbën shkak për përhapjen e sëmundjeve infektive. Aktualisht nuk kishte asnjë anëtar stafi apo të paraburgosur të infektuar me COVID-19. Në kuadër të vaksinimit vullnetar, stafi i punonjësve të administratës dhe të policisë së institucionit, ishin vaksinuar të gjithë me dy doza, ndërsa të paraburgosurit ishin vaksinuar në masën 80%, ndërkohë pjesa tjetër e të paraburgosurve ishin të pavaksinuar, për shkak se disa prej tyre kishin refuzuar bërjen e vaksinës.

Trajtimi

Grupi i inspektimit mori informacion nga drejtuesit e institucionit dhe zhvilloi intervista konfidenciale me të burgosurit, në lidhje me trajtimin e këtyre personave nga stafi i institucionit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar nga aktet normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave të të burgosurve, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion dhe komisioni për dhënien e masave disiplinore, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor të të dënuarve, cilësia e ushqimit, furnizimin sipas normativave me detergjentë dhe mjete të higjienës personale, etj.

Nga informacioni dhe në intervistat konfidenciale të zhvilluara me të paraburgosurit dhe të dënuarit rezultoi se, nuk kishte raste torture, të dhunimit fizik ose psikologjik apo përdorimit të tepruar të forcës fizike ndaj këtyre personave, nga personeli i sigurisë së shërbimit të policisë apo punonjësit e stafit civil që shërbejnë në këtë institucion.

Nga inspektimi i ambienteve në regjimin e brendshëm, u konstatua se gjendja teknike e godinës nr.1 ishte e amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të menjëhershme për rikonstruksionin e saj. Në vende të caktuara në pjesën e jashtme të godinës, muret ishin të dëmtuara, kishte rënë suvaja për shkak të lagështirës, që ishte prezente kudo, dhe ishte i nevojshëm hidroizolimi i tarracës.

Po ashtu veç inspektimit të ambienteve, ky shqetësim, u ngrit edhe në intervistat me të paraburgosurit. Lagështira ishte evidente në disa dhomat e të paraburgosurve, por më

e theksuar ishte në ambientin e tualeteve dhe të dusheve në çdo sektor. Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë prezenca e saj në këto ambiente, ndikon drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurve dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Personat e moshës 18-21 vjeç nuk ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualet e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të burgosurit e tjerë. Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, sistemimi i tyre në dhoma të veçanta, ishte i pamundur për shkak të mospërshtatjes dhe familjarizimit që ata kishin me të burgosurit e tjerë. Ajrimi dhe veprimtaritë me karakter sportiv dhe edukativ, për shkak të situatës të pandemisë, vijonin të zhvilloheshin me grupe të vogla dhe të ndarë sipas grup moshave dhe interesave të të burgosurve.

Në vijim të intervistave, të dënuarit/paraburgosurit ngritën ankesa që kishin të bënin me hapësirën e vogël të dhomave të banimit, duke patur parasysh faktin që në dhoma ishin akomoduar 3-4 persona. Hapësirat dhe sipërfaqet e dhomave nuk i përgjigjeshin standardit për normativën që ato duhet të plotësonin për një person, ashtu siç është e sanksionuar në aktet ligjore e nënligjore dhe në aktet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Një shqetësim tjetër që u ngrit si ankesë nga të paraburgosurit, ishte mungesa e kushteve dhe pajisjeve të nevojshme në ambientet e dhomave dhe klasave që ndodheshin në çdo sektor. Pavarësisht përpjekjeve të administratës dhe stafit të sigurisë të institucionit për ti kompletuar me materiale nga godinat e tjera, në disa dhoma kishte mungesa të orendive të nevojshme si dollapë (komodina) për vendosjen e rrobave, sendeve personale dhe për mbajtjen e ushqimeve, pasi në shumicën e dhomave që u inspektuan, ato mbaheshin me qeska të vendosura në tokë.

Nga intervistat u evidentua gjithashtu si shqetësim, se normativa mujore e detergjenteve dhe sapunëve për larje është e pamjaftueshme, pasi edhe pse ishte shpërndarë sipas normativës mujore, ata thanë se kjo sasi është e vogël dhe e pamjaftueshme për të përballuar muajin, gjë e cila reflektohej në mungesën e pastërtisë dhe kushteve higjieno-sanitare në dhoma.

Në lidhje me këto problematika, drejtuesit e institucionit informuan se, nisur nga përmasat e vogla që kanë dhomat e banimit dhe elementët e sigurisë fizike, ato e kushtëzojnë sigurimin e dollapëve për secilin person dhe vetëm të një komode për mbajtjen e ushqimeve dhe sendeve personale. Ndërsa në lidhje me normativat mujore të detergjenteve dhe sapunëve, ato shpërndahen sipas normativave mujore për person.

Ky argument, nuk është i drejtë dhe në përputhje me standardet që duhet të plotësohen për trajtimin dinjitoz dhe jo të diferencuar të të paraburgosurve. Përsa më sipër, në nenin 33 të ligjit 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, thuhet shprehimisht se: *“Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatësinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*. Në këtë kuadër, theksojmë nevojën e rishikimit të kapacitetit fizik të godinës ku janë akomoduar aktualisht të paraburgosurit, me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme për jetesë normale sipas standardeve. Ky rekomandim

është i përsëritur dhe Avokati i Popullit pret marrjen e masave të shpejta në lidhje me këtë çështje.

Në lidhje me stafin e institucionit, të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e prezencës në sektorë të punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore. Të paraburgosurit paraqisnin ankesa për punonjësit e këtij sektori në lidhje me nevojën që ata kishin për trajtime psiko-sociale, me qëllim uljen e stresit dhe të ankthit, për organizime të aktiviteteve specifike me programe të veçanta, si dhe për vonesa në marrjen në kohë të kërkesë/ankesave të të paraburgosurve drejtuar drejtorit të institucionit, si dhe institucioneve të tjera qëndrore e të pavarura. Të paraburgosurit ngritën me shqetësim një problem që kishte të bënte me mos vënien në dispozicion të korrespondencës me kthim përgjigje me shkrim që vinin në emrin e tyre nga DPB-ja dhe institucionet e tjera të pavarura, duke ju mohuar të drejtën e ankimit, pasi në shumicën e rasteve ankesat e tyre nuk merreshin në shqyrtim, për shkak të mosrespektimit të afateve nga ankuesit. Në këtë drejtim, grupi i inspektimit kërkoi regjistrin ku evidentohet një praktikë e tillë, por punonjësit e sektorit psiko-social e justifikonin me faktin se shkresat ju dorëzoheshin nominalisht çdo ankuesi, pa një dokument që vërtetonte marrjen në dorëzim të shkresave me përgjigje që hynin në institucion në emër të të burgosurve.

Gjithashtu, kishte ankesa dhe pretendime lidhur me kohëzgjatjen dhe zvarritjen e proceseve gjyqësore. Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e Institucionit të Avokatit të Popullit, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe organeve të larta të drejtësisë.

Klasat e edukimit ndodhen në secilin kat të godinës, dhe janë të kompletuara me karrige dhe tavolina, por gjatë periudhës së pandemisë ato kanë qëndruar të mbyllura, për të eliminuar grumbullimet në grupe dhe ruajtur distancimin fizik e social midis të paraburgosurve. Në kërkesat e parashtruara, të paraburgosurit kërkojnë që klasat të qëndrojnë të hapura edhe në periudhën e pasditës, pasi masat anti COVID-19 janë lehtësuar dhe për popullatën në tërësi⁵.

Në vijim të ankesave, të paraburgosurit ngritën si shqetësim që aktivitetet me karakter kulturor dhe edukativ, të jenë sa më të zgjatura. Aktivitet që zhvillojnë aktualisht të paraburgosurit ishin futbolli, lojra tavoline, domino dhe orari i ajrimit.

Në këtë aspekt, mungesën e aktiviteteve social-edukuese, sportive dhe kulturore për këtë periudhë, të paraburgosurit kërkonin ta kompesonin me zgjatjen e orarit të hapjes të klasave të edukimit, sipas sektorëve gjatë kohës të mbasditëve për zhvillimin e lojrave të ndryshme me grupe të vogla, me qëllim ruajtjen e shëndetit mendor dhe më pas rehabilitimin e kësaj kategorie.

Ankesa të shumta u ngritën nga të paraburgosurit për lejimin e takimeve fizike me familjarët e tyre. Nga ana e autoriteteve lejohej një takim në muaj, në distancë për shkak të masave shtërguese për parandalimin e pandemisë. Mungesa e takimeve fizike me familjarët ishte zëvendësuar me mënyrën alternative të takimeve online. Në ambientin e

⁵ Urdhër nr. 273 datë 26.04.2022 për shfuqëzimin e urdhërit nr.351 datë 29.05.2020 “Për marrjen e Masave të Veçanta dhe Kufizimeve për Parandalimin e Përhapjes së Covid -19”

takimeve ishte krijuar një dhomë për realizimin e katër takimeve online të të paraburgosurve me familjet e tyre, sipas numrit të përcaktuar në rregulloren e brendshme të burgjeve. Ndërsa, komunikimi me telefon nuk ishte ndërprerë në asnjë periudhë me familjarët.

Trajtimi i personave me masë mjekësore mjekim i detyruar

Një aspekt tjetër i vizitës inspektuese, kishte të bënte me monitorimin e situatës të trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor të transferuar në këtë institucion, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore” ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me datë 23.11.2021⁶, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim.

Në këto akte, përcaktohet qartë se, shtetasit me vendim gjykate “Mjekim i detyruar” dhe “Shtirim i përkohshëm”, **nuk** duhet të akomodohen në IEVP-të në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por duhet të trajtohen në një institucion të posaçëm mjekësor në varësi të MSHMS, situatë për të cilën deri tani nuk është ofruar asnjë zgjidhje.

Ligji nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar ka përcaktuar dhe ka evidentuar faktin se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtirim i detyruar”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor (pjesë e sistemit shëndetësor të integruar) dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Konkretisht, në nenin 28, pika 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Ky përcaktim ligjor, tregon qartë prioritetin që legjislativi i kanë dhënë mbrojtjes së shëndetit të këtyre personave, para natyrës së veprës penale që kanë kryer, si dhe ka përcaktuar institucionet mjekësore të posaçme, ku duhet të kryhet trajtimi mjekësor i tyre.

Pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase, si dhe iniciativave sporadike nga ana e qeverive ndër vite për të ndërtuar një institucion të veçantë për personat me masë mjekësore me vendim gjykate, deri tani nuk është arritur asnjë rezultat konkret.

Në momentin e kryerjes së vizitës inspektuese në IEVP Lezhë në datë 17 shkurt 2022, në seksionin e personave me masë mjekësore **ishin akomoduar në total 349 persona**, nga të cilët 225 shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, 119 shtetas me masë

⁶ Regjistruar në MD me nr.6111 prot., datë 23.11.2021 dhe MSHMS nr.4787 prot., datë 23.11.2021

mjekësore “shtrim i përkohshëm”, si dhe 5 shtetas të dënuar me vendim gjykate, paraplegjik.

Ndërkohë, sipas projektit të ndërtimit, ambientet në dy godinat e I EVP Lezhë ishin pajisur me shtretër për mbajtjen dhe trajtimin e **184 shtetasve** me masë “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”, veç ambienteve të destinuara si sallë për urgjencat, laboratorët, klinikat mjekësore të mjekëve, dhomat e infermierëve, personelin mbështetës (sanitar dhe kujdestarë), si dhe ambienteve për punën e administratës. Në secilën nga dhomat ndodheshin gati 2 herë më shumë persona sesa kapaciteti, duke i bërë kushtet të papërshtatshme për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre. Pavarësisht mbipopullimit, personat e akomoduar flinin të tërë në shtretër dhe asnjëri prej tyre nuk flinte me dyshekë në tokë.

Gjatë kohës të funksionimit të I EVP “Zahari”, Krujë, por edhe aktualisht në I EVP Lezhë, Institucioni i Avokati i Popullit, ka evidentuar një problematikë që lidhet me vendimet e gjykatave kompetente për dhënien e masës mjekësore për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe me ekzekutimin e vendimeve penale me masë “shtrim i përkohshëm”, duke i akomoduar në ambientet e këtyre I EVP-ve dhe jo në një institucion të posaçëm mjekësor, brenda sistemit shëndetësor të integruar.

Referuar statistikave në vite për personat me masë mjekësore në I EVP “Zahari”, Krujë, por edhe aktualisht në I EVP Lezhë, rezultojnë të jenë rreth 50% e pacientëve të akomoduar, për të cilët gjykata ka vendosur masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”, për faktin se ata janë me çrregullime apo probleme të shëndetit mendor, por nuk kanë kryer asnjë vepër penale, ndaj kjo kategori nuk mund të mbyllet në ambientet e I EVP-së.

Këta persona, pavarësisht masës mjekësore të vendosur nga gjykata, duhet të veçohen nga personat e tjerë me masë mjekësore “mjekim i detyruar” që kanë kryer vepra penale, ndaj është e domosdoshme që të trajtohen në institucione të posaçme të shëndetit mendor.

Trajtimi dhe akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, mbi kapacitetin fizik në I EVP Krujë, por edhe në IVSHB (Spitali i Burgjeve), është denoncuar vazhdimisht nga Institucioni i Avokati i Popullit, si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues të këtyre pacientëve dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore.

Personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes së tyre.⁷ Megjithatë, situata e mbipopullimit, ka ardhur në rritje konstante nga viti në vit. Një problem tjetër thelbësor është veç mangësive të investimeve, këto persona përballen edhe me mungesë të theksuar të shërbimit të përshtatshëm mjekësor. Mungesat në stafin mjekësor të specializuar, si dhe në radhët e ekipit multidisiplinar e bëjnë të trajtimin shëndetësor sipas standardeve. Drejtoria e Burgjeve nuk është treguar proaktive për të rritur numrin e personelit shëndetësor në rastin e mbipopullimit, veçanërisht për rastet e personave me probleme të shëndetit mendor.

⁷ CPT/Inf (92) 3 – part 2, parag. 56.

Në komunikimet që kemi patur me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, jemi informuar se, prej kohësh ishte planifikuar të nënshkruhej një marrëveshje bashkëpunimi mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm, ku do të parashikohen detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit institucion përgjatë këtij procesi ⁸ në kuadër të një zgjidhje, që do të përmirësonte ndjeshëm cilësinë e kushteve dhe trajtimit të këtyre personave. *Por, kjo marrëveshje nuk është hartuar deri në nëntorin e vitit 2021.*

Referuar përgjigjes së Qeverisë Shqiptare për zbatimin e rekomandimeve të CPT-së⁹, ndërtimi, përshtatja e godinave për personat me masë mjekësore në IEVP Lezhë, si dhe administrimi i personelit shëndetësor nën juridiksionin e MSHMS, duhet të përfundonte brenda vitit 2019. Brenda këtij afati kohor, përfshihej edhe transferimi i këtyre personave nga IEVP Zahari, Krujë, për në godinat e reja të ndërtuara në IEVP Lezhë.

Periudha e pandemisë (viti 2020-2021), ishte një faktor tjetër që sipas DPB ndikoi në ngadalësimin e zbatimit të procesit të transferimit të personave me masë mjekësore, pasi me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, një nga godinat e rikonstruara u kthye në spital për shtrimin e të burgosurve në sistemin e burgjeve, të infektuar me COVID-19.

Avokati i Popullit konstaton me keqardhje se interesi i personave të sëmurë me probleme të shëndetit mendor nuk ka qenë në vëmendjen e duhur dhe nuk janë marrë masat e nevojshme dhe të domosdoshme për të lehtësuar sadopak situatën e këtyre personave.

Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr.8927/1, datë 27.09.2018 “Për klasifikimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve miratoi Planin e Masave me nr.1240 prot., datë 18.11.2021 “Për transferimin e shtetasve me masë mjekësore nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë”, duke i krijuar mundësinë strukturave përgjegjëse të sigurisë dhe atyre të shëndetësisë në përbërje të DPB-së, IEVP “Zahari”, Krujë dhe IEVP Lezhë, të kryejnë transferimin e personave me masë mjekësore, për në ambientet e krijuara në godinat e reja, në datat 27 – 29 Nëntor 2021.

Avokati i Popullit, në lidhje me situatën dhe problematikat në të cilën ndodheshin personat e akomoduar në IEVP Zahari, ka dërguar në muajin nëntor të vitit 2021 një rekomandim drejtuar autoriteteve shtetërore përgjegjëse të ngarkuara me ligj, ku ndër të tjera ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me kapacitetet akomoduese të strukturës së re në IEVP Lezhë, si dhe për kompletimin me staf shëndetësor shtesë që do të duhet të kishte struktura

⁸ <https://kmd.al/ep-content/uploads/2019/02/Vendim-nr.-255-date-19.12.2018-A.B-kunder-MSHMS.pdf>
faqja 6

⁹ <https://rm.coe.int/16809cb571/> Raporti me rekomandime i CPT 2019 dhe përgjigjet e Qeverisë Shqiptare. <https://ëëë.drejtësia.gov.al/neësroom/lajme/rikonstruktohet-spitali-i-burgjeve-kushte-dinjitoze-per-sherbimin-shendetesor-per-te-denuarit/>

e re, sipas standardeve dhe protokolleve shëndetësore për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor¹⁰.

Ndërkohë nga vizita inspektuese në I EVP Lezhë, vetëm 3 muaj nga transferimi i tyre nga I EVP Krujë, u evidentua se situata ndonëse në përmirësim, mbetet përsëri problematike. Në konstatimin tonë godinat nr.4 dhe nr. 5 ende nuk janë të pajisura me të gjithë infrastrukturën dhe bazën e nevojshme mjekësore për trajtimin e këtyre personave. Struktura aktuale shëndetësore, por dhe stafi ndihmës (sanitarë dhe kujdestarë) i I EVP Lezhë nuk i përmbushin kërkesat për ofrimin e këtij shërbimi personave me çrregullime të shëndetit mendor, pasi kapacitetet janë shumë të vogla në numër për të përballuar numrin e madh të personave të akomoduar në këtë I EVP dhe ndër të tjera për ti trajtuar në bazë të protokollit shëndetësor edhe personat e transferuar rishtaz në këtë institucion.

Sikurse parashikohet në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, menaxhimi i këtij spitali duhet të kalonte tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, masë kjo që është shumë larg plotësimin të këtij detyrimi ligjor.

Drejtuesit e I EVP Lezhë për arsye të menaxhimit të kushteve në të cilat ndodhen për shkak të mbipopullimit, janë detyruar të shtonin numrin e shtretërve dhe personave në dhoma nga 2 në 4 deri dhe 7 persona, madje duke përshtatur në dhoma banimi edhe ambientet të cilat ishin të parashikuara për punën e stafit të administratës dhe stafin ndihmës dhe mbështetës.

Avokati i Popullit, në raportet vjetore drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, sidomos të këtyre 4 viteve të fundit, në lidhje me trajtimin e personave me masë mjekësore, ka sugjeruar rritjen e kapaciteteve akomoduese të institucioneve të sistemit penitenciar në përballimin e numrit gjithnjë e në rritje të vendimit të gjykatave në dhënien e masave mjekësore për personat me çrregullime të shëndetit mendor.

Përveç problematikave me infrastrukturën, trajtimit dhe mungesës së kushteve rekreative për këta persona me masë mjekësore, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë rekomandime për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike të I EVP Shënkoll Lezhë¹¹. Stafi mjekësor dhe ai i sigurisë ishin ende në përbërje të I EVP Zahari, Krujë dhe nuk i përgjigjej numrit të personave të akomoduar në I EVP Lezhë. Ata kryenin detyra si të komanduar, sipas funksioneve me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, deri në miratimin e strukturës së re organike për këtë institucion.

¹⁰ Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Drejtësisë me shkresë nr.6667/1 prot., datë 17.01.2022 drejtuar Avokatit të Popullit, ka shprehur dakortësinë për çështjet e ngritura nga AP dhe thekson se: “Po merren masa në bashkëpunim me MSHMS, në përputhje me detyrimet e marrëveshjes së bashkëpunimit regjistruar pranë MD me nr.6111 prot., datë 23.11.2021 dhe regjistruar pranë MSHMS me nr.4787 prot., datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore”.

¹¹ Dërguar Rekomandimi Drejtuar Ministrisë Drejtësisë dhe Ministrisë Shëndetësisë, për dijeni Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, me nr. K4/I8-2 Prot, datë 18.03.2022, ku rekomandohet “Përmirësimi i kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike në I EVP Shënkoll Lezhë”.

Situata e kompletimit me stafin shëndetësor, stafin mbështetës dhe psiko-social, edhe pas transferimit në ambientet e reja në IEVP Lezhë, paraqitet me mangësi krahasuar me numrin në rritje të personave me çrregullime të shëndetit mendor, që akomodohen në institucionet e sistemit penitenciar. Aktualisht përbërja e personeli shëndetësor me kohë të plotë është si më poshtë:

- 6 mjekë: 2 mjek psikiatër, 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 1 stomatolog dhe 1 farmacist;
- 11 personel i mesëm mjekësor: 1 kryeinfermier dhe 10 infermierë;
- 10 personel mbështetës: 5 kujdestarë dhe 5 sanitarë;
- 8 punonjës të sektorit psiko-social: 6 punonjës social dhe 2 psikolog.

Në datën e inspektimit, grupi monitorues mundi të takojë vetëm stomatologun dhe farmacistin pasi vetëm ata ishin të pranishëm.

Mungesa e kapaciteteve administrative në plotësimin dhe shtimin e kapaciteteve të stafit shëndetësor për trajtimin mjekësor të këtyre personave, nuk është e justifikueshme, dhe në këtë rast kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas legjislacionit në fuqi.

Sikurse e referuam edhe më lart, ndër vite kjo kategori personash ka vuajtur dhe jetuar në kushte jo dinjitoze dhe në kundërshtim me aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, për të cilat shteti shqiptar është ndëshkuar në lidhje me këtë problematikë.

Për këtë kategori personash, është shprehur edhe GJEDNJ në çështjen “*Strazimiri kundër Shqipërisë*”¹², për të cilën konstatoi në veçanti që kishte pasur një dështim të gjatë nga autoritetet shqiptare për të ngritur një institucion të posaçëm mjekësor për të sëmurët mendor, të cilët ishin privuar nga liria në rastet e trajtimit të detyrueshëm mjekësor të urdhëruar nga gjykata vendase.

Në këtë aspekt, mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar, përbën dhunim të rëndë të të drejtave të tyre, pasi në një farë mënyre i vendos ata në një formë të përjetshme të privimit të lirisë¹³. Kjo pasi, gjendja e papërgjegjshmërisë mendore tek të sëmurët mendorë kronikë mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së tyre, dhe si rrjedhim, edhe izolimi në institucione të veçanta do të ishte i përjetshëm.

Një zgjidhje e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave do të ishte ngritja e qendrave të trajtimit psikiatrik ligjor (Forensic Psychiatric Centers), si struktura në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Për të siguruar një trajtim sa

¹² Ky rast kishte të bënte me ndalimin e një njeriu, i cili ishte përjashtuar nga përgjegjësia penale për shkak të sëmundjes mendore, në një burg në vend të një institucioni mjekësor. Parashtruesi ankohej në veçanti se kushtet e ndalimit të tij, përfshirë sigurimin e kujdesit mjekësor, ishin joadekuate. Ai po ashtu konsideronte se ishte vendosur në një burg edhe pse gjykatat kishin urdhëruar mbylljen e tij në një institucion mjekësor, se nuk i ishte dhënë mundësia që ligjshmëria e ndalimit të tij të vendosej shpejt nga një gjykatë dhe se ligji i brendshëm nuk i kishte ofruar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

¹³ Albrecht, H.J. Plenary speech – Punimet e Konferencës së dytë vjetore të Max Planck Partner Group on Balkan Criminology, ‘Imprisonment in the Balkans’, 17-19 shtator 2015, Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

më kompetent dhe sa më afër nevojave të të sëmurëve mendorë programet e ofruara në këto qendra duhet të fokusohen në dy linja kryesore veprimi:

- a) ofrimi i ndihmës së specializuar mjekësore dhe klinike dhe;
- b) ofrimi i trajtimeve me bazë komunitare që mundësojnë vendosjen e tyre të monitoruar në mjedise gjysmë të hapura.

Në përgjigjen e Qeverisë Shqiptare për zbatimin e rekomandimeve të CPT-së gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, theksohet se: *“Aspektet e angazhimit reciproke në drejtim të trajtimit të kësaj kategorie në spitalin e ri në mjediset e IEVP Lezhë, do të përcaktohen në një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”*¹⁴.

Konkretisht në përmbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit përcaktohet se:

Ministria e Drejtësisë merr përsipër:

- a) Vendosjen në dispozicion të pajisjeve që disponon, me qëllim përshtatjen dhe pajisjen me aparataturat e nevojshme të dy godinave pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor, Lezhë duke siguruar mjedis fizik të përshtatshëm për ofrimin e kujdesit terapeutik, human dhe të sigurtë për personat me crregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr 44/2012 “Për shëndetin mendor”.
- b) Ofrimin e masave të sigurisë për ruajtjen e këtij institucioni.
- c) Vazhdimin dhe përmirësimin e kujdesit të sigurtë nëpërmjet rishikimit të protokolleve dhe procedurave për funksionimin e këtij institucioni transitor dhe trajnimeve të stafit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr përsipër:

- a) Ofrimin e shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve sipas nevojave.
- b) Sigurimin e diagnostikimit dhe trajtimit të specializuar.
- c) Ofrimin e ekzaminimeve laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë nëpërmjet ISHP-së.
- d) Planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik.

Sa më lart, kjo marrëveshje hedh hapat e parë për finalizimin dhe mbylljen e një procesi të zvarritur prej më shumë se 10 vite dhe me një kosto për pacientët, që vuajnë dënimin në një institucion brenda sistemit penitenciar dhe jo në një Institucionit Mjekësor të Posaçëm, por në vlerësimin tonë Marrëveshja, nuk ka të përcaktuar mënyrën e përshtatshme në frymën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe rekomandimet e CPT-së, pasi mungon një afat kohor se:

¹⁴ <https://rm.coe.int/16809cb571>

- a) kur do të ngrihet Institucioni Mjekësor i posaçëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) cila do të jetë organika e Institucionit Mjekësor të Posaçëm;
- c) cila ka qenë organika e miratuar në IEVP “Zahari”, si dhe cilat janë nevojat aktuale për plotësimin e stafit mjekësor dhe atij mbështetës, në kushtet e mbipopullimit dhe pas transferimit në ambientet e reja në IEVP Lezhë;

Në veçanti nuk rezulton që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ketë rritur praninë mjekësore në IEVP Lezhë dhe as të jetë bërë vlerësimi i nevojave në këtë institucion.

Ndaj në kushtet aktuale, kur është evidente situata e mbipopullimit dhe mungesa e miratimit të strukturës organike të përshtatshme në IEVP Lezhë, kërkohet nga autoritetet përgjegjëse shtetërore si Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të kryejnë menjëherë një studim mbi numrin e personave që janë me masë mjekësore në sistemin e burgjeve, stafet mjekësore në dispozicion të DPB, si dhe cilat janë kapacitetet fizike për mbajtjen dhe trajtimin e tyre.

Avokati i Popullit, për sa më lart tërheq vëmendjen e autoriteteve shtetërore për mungesën e hartimit të këtij studimi, i cili duhet të ishte përfunduar para se të kryhej transferimi i këtyre personave nga IEVP “Zahari”, Krujë në IEVP Lezhë. Ky studim, duhet të fokusohet në rritjen e kapaciteteve mbajtëse për personat me masë mjekësore dhe njëkohësisht duhet të evidentojë nevojën për shtimin e stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse për këtë kategori, pasi kapaciteti fizik i dy godinave të reja dhe stafi aktual mjekësor i transferuar nga IEVP Zahari, Krujë, është i pamjaftueshëm për të akomoduar dhe trajtuar personat me masë mjekësore, sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare, për këtë qëllim.

Gjithashtu, kjo problematikë është evidentuar edhe në raportin me rekomandime të CPT-së gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri në vitin 2018, sipas të cilit *kushtet e jetesës në këto dy institucione ishin përkeqësuar më tej që nga vizita e vitit 2014 (në veçanti për sa i përket gjendjes së riparimit dhe mbipopullimit)¹⁵, dhe niveli i kujdesit psikiatrik ishte qartë i pamjaftueshëm.*

CPT ka kërkuar:

- *informacion të detajuar mbi hapjen e objektit psikiatrik në burgun e Lezhës (përfshirë mënyrën e menaxhimit të kësaj strukture, numrin e stafit të përkujdesjes shëndetësore dhe të stafit tjetër të specializuar, trajnime të stafit, mënyrën e sigurisë, mundësimin e aktiviteteve terapeutike dhe rekreative etj).*
- *konfirmimin se të gjithë pacientët janë transferuar në Lezhë.*
- *një kopje të konceptit të rishikuar për ndërtimin e institucionit psikiatrik në Tiranë”.*

¹⁵ Më datë 2.12.2020 rezulton se kapaciteti i këtij institucioni është 196 persona, ndërkohë që aktualisht ndodhen 292 persona. Mbipopullim 96 persona.

Për sa më sipër, ndër të tjera rezulton të jetë evidente se niveli i kujdesit shëndetësor në vitin 2018, ka qenë në kushtet e braktisjes terepautike të shumë pacientëve. Përsa nuk ka patur asnjë përmirësim të stafit mjekësor, në vlerësimin e Avokatit të Popullit, situata e braktisjes terepautik e konstatuar që në vitin 2018, ende nuk ka ndryshuar.

Në përfundim, ritheksojmë se ky institucion ka në organikë një numër modest personeli shëndetësor, i cili nuk është në gjendje të përballojë as fluksin aktual, as atë në rritje të personave të shtruar me masë mjekësore, dhe për këtë është e nevojshme dhe e domosdoshme shtimi i personelit shëndetësor i përbërë me mjek të përgjithshëm, mjek psikiatër, mjek kardiolog, mjek laborant klinik biokimik, infermierë, sanitarë dhe kujdestarë për pacientë me masë mjekësore, si më poshtë vijon:

- a) *Spektori shëndetësor në seksionin e masave shëndetësore nga 18 personel shëndetësor aktual, të bëhet me 36 mjekë dhe infermierë.*
- b) *Sanitarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 sanitarë.*
- c) *Kujdestarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 kujdestarë.*

Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe për dijeni Kryeministrin të Shqipërisë, “ Përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale(IEVP) Lezhë”.¹⁶

Një problematikë tjetër, që u ngrit nga stafi social gjatë inspektimit ishte braktisja e personave me vendim gjykatë, kurim ambulator, nga familjarët e tyre dhe për pasojë rikthimi i tyre në institucion si persona me masë mjekësore.

Për shkak të kontigjentit të akomoduar në institucion, ku aktualisht lista emërore e shtetasve me masë mjekësore të braktisur nga familjarët është 114 persona, Spektori i Çështjeve Shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t’i ardhur në ndihmë këtyre shtetasve. Vlen të theksohet se Kisha Katolike luan një rol bazë në sigurimin e veshmbathjeve në sasi të mëdha për të gjithë kategorinë e akomoduar në institucion.

Grupi monitorues inspektoi edhe situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe ato higjienike të të burgosurve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 5 dhoma observimi dhe 8 dhoma veçimi. Në ditën e inspektimit në ambientin e observimit u konstatua se ato ishin të pajisura nga 2 deri 3 krevatë, me dyshek, batanie si dhe çarçaf por mungonin tavolina stola, komodina etj. Në ditën e inspektimit në ambientet e observimit ndodheshin 10 të paraburgosur që qëndronin aty për mospërshtatjen në sektorin e regjimit të brendshëm, si dhe personat që ishin kthyer nga karantinimi për 14

¹⁶ Të dërguar rekomandimi nr. K4/I8-2 prot, datë 18.03.2022, “ Për përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, si dhe rregullimet ligjore në strukturën organike të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë”.

ditë. Sipas informacionit, disa nga këto persona ishin problematik dhe nuk ishin përshtatur me kushtet në sektorët e tjerë dhe qëndronin në këtë ambient me dëshirën e tyre. Ndërsa në ambientin e veçimit ndodheshej 1 person, në pritje të zhvillimit të mbledhjes së Komisionit të Disiplinës së institucionit, për dhënie të masës disiplinore. Ambienti në tërësi ishte i lyster, por mungonte pastërtia nga ana higjieno-sanitare. Dhoma e veçimit ishte e pajisur me krevat, dyshek, batanie, por mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Gjithashtu, për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (3 dushe me ujë të ngrohtë) i cili ndodhej në fund të korridorit, si dhe 3 tualete të përbashkëta, të cilat ishin funksionale për këtë qëllim.

Mungesa e kushteve higjieno-sanitare kryesisht në dhomat e observimit, dhomat e veçimit, si dhe ambientet e përbashkëta të dusheve, ishte një problematikë që u evidentua qartë gjatë inspektimit të këtyre ambienteve. Nga inspektimin në vend, por edhe nga intervistat me të paraburgosurit, u konstatua se këto ambiente nuk ishin të pastra dhe të lyera, si dhe kishte prezencë të lagështirës e cila dëmton shëndetin e tyre.

Nga informacioni dhe intervistat me të paraburgosurit, u evidentua gjithashtu edhe problemi i ngrohje/ftohjes në dhoma dhe mungesa e një sistemi qëndror, që do të realizonte këtë gjë. Në mungesë të këtij sistemi, drejtuesit e institucionit për periudhën e dimrit kishin lejuar mbajtjen e pajisjeve elektrike të siguruara nga familjarët e të paraburgosurve.

Në organikën e IEVP-së, Shënkoll Lezhë, ishin të punësuar 15 të burgosur nga të cilët 14 ishin të punësuar kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës ushqimi, kuzhiner, bojaxhi, lavaxhi, lulishtar etj.

Në kushtet, kur Këshilli i Ministrave ka miratuar së fundmi vendimin për *“Për rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin për punën e kryer”*¹⁷, të paraburgosurit ishin informuar menjëherë për kriteret, kushtet dhe shpërblimin e punës, me qëllim nxitjen dhe stimulimin e punësimit nga radhët e tyre. Mekanizmi Kombëtar kërkon monitorimin në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, për rregullat e posaçme të punësimit.

Masat mbrojtëse

Nga inspektimi dhe verifikimi i dokumentacionit lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej¹⁸. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin punonjësit të sektorit psiko-social. Më tej, punonjësi i këtij sektori i dërgonte kërkesë/ankesat në sekretarinë e institucionit, ku ato protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo i takonte vetë të dënuarit.

¹⁷ Në datë 13.10.2021 u miratua vendimi i KM *“Për rregullat e posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin për punën e kryer”*.

¹⁸ Neni 49 i ligjit Nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Përsa i takon objektit të kërkesë/ankesave, nga verifikimi i tyre rezultoi se, në shumicën e tyre ankesat konsistojnë në kërkesa për leje shpërblyese, takime me familjarët, kërkesë për dinamikën e vuajtjes së dënimit, kërkesë për takim me avokatë, vizitë në spitalin rajonal, transferim, punësim etj.

Grupi i inspektimit mori informacion për zbatimin e procedurave për pritjen e të paraburgosurve në Institucion, si dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Pritjes. Nga verifikimi i dokumentacionit, ky komision mbledhëj rregullisht dhe kishte në përbërjen e tij përfaqësues nga sektori ligjor, sektori i ruajtjes dhe sigurisë, sektori i kujdesit social dhe sektori i shëndetësisë. Të dhënat regjistroheshin në formularin përkatës dhe më tej pasqyroheshin në një regjistër të posaçëm. Mjeku bënte pjesë në Komisionin e Pritjes, ndërsa në Komisionin e Disiplinës ishte prezent në rolin e vëzhguesit. Sipas informacionit, por dhe nga verifikimi i praktikave dhe regjistrimit, gjatë periudhës së pandemisë, masat disiplinore ndaj të paraburgosurve, kryesisht ato për kalimin në dhomat e veçimit, kanë qenë më të reduktuara.

Nga verifikimi i regjistrimit, objekti i kërkesave të të paraburgosurit kishte të bënte me kërkesa për blerje tv, biseda në skype me familjen, aplikim për hapje llogarie në bankë, mungesa të medikamenteve mjekësore, pajisjen me kopje të vendimit të gjykatave, konsulenca juridike etj.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale IEVP Shënkoll, Lezhë monitorohej nga sistemi i kamerave, të cilat mbanin në vëzhgim mjediset në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, i cili ishte funksional. Kamerat monitoronin gjatë 24 orëve dhe të dhënat e tyre ruheshin në një server qendror për një periudhë 30 ditore.

Komunikimin me telefon me familjet e tyre, të paraburgosurit e zhvillonin normalisht me telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe të burgosurit kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre. Sa i takon komunikimit me telefon me institucionin e Avokatit të Popullit, të burgosurit ngritën shqetësimin se nuk mund të flisnin lirisht, pasi numrat e telefonit të institucionit nuk ishin të lidhur drejtëpërdrejtë pa kartë dhe pa pagesë nga kompania që ofronte këtë shërbim. Ky shqetësim është ngritur vetëm pasi ka dalë urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve Nr.4218 Prot., datë 13.05.2019 *“Për kufizimin e numrave të telefonatave dhe administrimin e tyre që kryhen nga të dënuarit dhe të paraburgosurit në Institucionet të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale”*.

Gjithashtu, në lidhje me sistemin e aparateve të telefonave, mbetet problematik fakti që në sistemin e burgjeve aktualisht operon vetëm një kompani telefonike nga dy kompani që kanë funksionuar rregullisht, gjë e cila ka sjellë për pasojë zvogëlimin e numrit të aparateve në gjendje pune dhe për pasojë uljen e numrit të telefonatave dhe minutazhit të kartave telefonike, shqetësim ky i ngritur në intervistat me të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

Ambienti i takimeve të të paraburgosurve me familjarët në IEVP Shënkoll, Lezhë kishte 2 poste për takime online, 2 poste për takime fizike me familjarët e të paraburgosurve dhe 2 dhoma për takime speciale me familjarët. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin një takim fizik dhe tre takime online me familjarët e tyre, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve. Sa i përket dhomave të takimeve speciale ato ishin të mobiluara me të gjitha pajisjet e hotelerisë në

funksion për këtë qëllim, por ato nuk kishin funksionuar që nga marsi i viti 2020 për shkak masave të marra në kuadër të pandemisë Covid 19¹⁹.

Në IEVP Shënkoll, Lezhë nuk kishte ambiente/dhoma prindërimi në distancë, ku të paraburgosurit mundet të takonin fizikisht fëmijët e tyre.

Në IEVP Shënkoll, Lezhë, funksiononte normalisht lavanderia, tashmë të 2 lavatriçet ishin në punë, ku të dënuarit dhe të paraburgosurit merrnin shërbim pa vështirësi.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitete të të paraburgosurve.

Godina kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, në Shënkoll, Lezhë përbëhej nga 1 godinë tre katëshe, me 38 dhoma në total. Në regjimin e brendshëm, akomodimi dhe aktiviteti ditor i të paraburgosurve kryhej vetëm në godinën nr.1, e cila ishte funksionale. Vendosja dhe akomodimi i të paraburgosurve në dhoma ishte me 3 deri 4 persona. Sipërfaqja e dhomave varionte nga 15 m² deri 18 m², ndërsa kubatura ishte deri në 4 m³ për person. Në këto kushte, jo të gjitha dhomat përmbushnin standardin e përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare, në lidhje me sipërfaqen dhe hapësirën jetike për person.

Referuar standardeve që përcaktohen në dokumentet e miratuara për këtë qëllim, përcaktohet qartë se, në vendosjen e të paraburgosurve apo të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo IEVP-je por *“në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike. Të paraburgosurve apo të dënuarve u sigurohet energji elektrike e nevojshme për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale”*.²⁰ Gjithashtu, ndërmjet godinës kryesore, ishte ish godina e seksionit për të miturit në konflikt me ligjin. Aktualisht kjo godinë kishte 6 dhoma, me kapacitet 12 persona, të cilat shërbenin për qëndrimin e të paraburgosurve, ku secila dhomë kishte nga dy të paraburgosur.

Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që lejonin hyrjen e dritës dhe ajrimin natyral. Dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme. Të paraburgosurit ishin të pajisur me krevatë, dyshekë, batanie e çarçafë për fjetje, si dhe komodina për mbajtjen e sendeve personale.

Ambientet e institucionit furnizoheshin me energji elektrike nga rrjeti elektrik i zonës. Nga informacioni, u evidentua se së shpejti do të fillonte investimi nga OSHEE, për

¹⁹ Urdhër nr. 273 datë 26.04.2022 Për shfuqizimin e urdhërit nr.351 datë 29.05.2020” “ Për marrjen e Masave të Veçanta dhe Kufizimeve për Parandalimin e Përhapjes së Covid -19”

²⁰ Neni 33, pika 4 e ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe Neni 30 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

ndërtimin e një linje të veçantë për furnizimin me energji të këtij institucioni. Gjithashtu, kishte dhe burim rezervë për furnizimin me energji elektrike me gjeneratorë.

Grupi i inspektimit, kontrolloi regjistrat për furnizimin me detergjentë të të paraburgosurve për mbajtjen e higjienës personale, pastërtinë në dhoma dhe për larjen e enëve, ku rezultoi se ishin shpërndarë sipas normativave mujore. Kjo, u evidentua në intervistat me të paraburgosurit të cilët pranonin furnizimin me detergjentë, por shpërndarja për person në sasi është shumë e vogël dhe kërkonin rritjen normative mujore për të plotësuar nevojat personale të tyre. Ata deklarorin se pjesën më të madhe të detergjenteve i siguronin nga familjet e tyre.

Dhomat e banimit ishin të pajisura brenda me tualete, të cilat në përgjithësi ishin të pastra nga ana higjeino-sanitare por ka nevojë çdo kohë për lyrje dhe dizinfektim, ku kishte edhe lagështirë. Ambienti i dusheve për larjen e trupit ishte i përbashkët dhe ndodhej në fundin e korridorit të çdo sektori, ku secili sektor kishte nga 4 dushe të cilët ishin funksionale. Në këto ambiente ndihej një erë e rëndë myku, për shkak të nivelit të lartë të lagështirës, e cila ndikon në shëndetin e personave të akomoduar në dhoma. Ato kishin nevojë për mbajtjen pastër nga të paraburgosurit, por dhe për dezinfektimin e herë pas hershëm të tyre nga sektori i logjistikës së këtij institucioni. Ndërkohë, godina e banimit ka nevojë për kryerjen e një rikonstruksioni të plotë të saj, për eliminimin e lagështirës.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm ishte 24 orë dhe përdorej për larjen e trupit dhe pastërtinë higjeno-sanitare të ambienteve, të institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Shënkoll, Lezhë.

Kuzhina ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme të godinës. Ambienti brenda ishte i pastër dhe kishte kushte të mira higjeno-sanitare, por kishte nevojë për lyrje, si dhe për vënien në funksion të aspiratorit, pasi kishte dalë jashtë funksionit sistemi i aspirimit rreth një vit më parë. Gjithashtu, kishte të nivel të lartë të lagështirës, i cili ishte problem shqetësues në ambientet e gatimit. Në kuzhinë punonin katër kuzhinierë dhe një punonjës mirëmbajtje. Menuja e përditshme ishte e afishuar. Gjithashtu, kampionet e ushqimit ishin të etiketuar dhe mbaheshin me çelës në ruajtje në frigorifer, për çdo vakt ushqimi. Për personat diabetikë ishte hartuar një menu e veçantë. Përgjithësisht, nga intervistat e kryera me të paraburgosurit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, por ata ngritën si shqetësim larmishmërinë dhe normën e ushqimit, e cila nuk u përgjigjej nevojave të tyre. Mungesa e larmishmërisë është si rezultat i normave të ulta të ushqimit ditor, të përcaktuara përcaktuara në urdhërin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.²¹

Në këto kushte, të paraburgosurit merrnin ushqime nga familjet e tyre, ose i blinin te njësia tregtare që ndodhej në regjimin e brendshëm dhe i gatuanin në dhomat e tyre. Kuzhina furnizohej rregullisht me ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë që përdorej për gatim dhe larjen e enëve. Personeli që punonte në kuzhinë ishte i plotësuar sipas organikës dhe ishte i pajisur me librezë shëndetësore. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menusë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar.

Regjimi dhe aktivitetet

²¹ Urdhër i përbashkët i Ministrit të Drejtësisë nr.104/5 prot., datë 19.07.2006 dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.205/3 prot., datë 27.07.2006 "Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit".

Aktivitetet e të burgosurve/paraburgosurve në godinën nr.1, orari i veprimeve, përfshirë këtu zgjimin, rregullimin dhe pastrimin e dhomave dhe ambientit të përbashkët, puna edukative e profesionale etj, ishte i afishuar. Nga bisedat me të dënuarit, grupi i inspektimit mori informacionin se ajrimi ishte një aktivitet i kryer sipas standardeve dhe bazuar në një grafik paraprak për çdo sektor, por dhe grup moshë. Grupi i monitorimit konstatoi se kishte disa mjedise të jashtme, të cilat përdoren për ajrim.

Gjatë inspektimit u vu re se zhvilloheshin shumë pak aktivitete të përbashkëta. Aktivitetet ishin të kufizuara dhe zhvilloheshin me grupe të vogla të të paraburgosurve, për shkak të masave kufizuese të vendosura në kuadër të situatës të emergjencës shëndetësore COVID-19. Staf i sektorit për çështjet shoqërore nuk ushtronte efektivisht detyrën në këtë institucion, pasi të vetmet aktivitete që organizonin ishin lojrat e tavolinës, ajrimi dhe futbollit, të cilat nuk ngjallnin interesin dhe kreativitetin e të paraburgosurve. Shumë prej të intervistuarve, kërkuan të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive, si dhe më shumë mjete dhe pajisje sportive, me qëllim shtimin e aktiviteteve edukative e social-kulturore për rehabilitimin dhe riintegrimin e të paraburgosurve. Për këtë fushë kërkohet një bashkëpunim më i mirë me organizatat jofitimprurëse.

Gjithashtu, nga verifikimi i praktikës të punës të këtij sektori, grupi i inspektimit konstatoi se, efektivisht mungonin dhe trajtimet individuale psiko-sociale me të paraburgosurit dhe burgosurit, kryesisht atyre që paraqisnin probleme të shëndetit, gjë e cila u verifikua dhe nga intervistat e zhvilluara me ata. Për rrjedhojë, dosjet psiko-sociale individuale për çdo të burgosur ishin të plotësuara në mënyrë fiktive sipas rubrikave, pasi dhe të paraburgosurit që duhet të jenë përfituesit e këtyre aktiviteteve, ngrinin si shqetësim mungesën e kontakteve të vazhdueshme e periodike me punonjësit e këtij sektori.

Në këtë institucion, ndodhej edhe një ambient që shërbente si bibliotekë, por që kishte një numër të reduktuar me tituj librash, të cilët ishin dhuruar nga organizata jofitimprurëse. Në katin e parë të godinës së banimit, ndodheshin edhe dy ambiente për kryerjen e riteve fetare për të burgosurit e fesë myslimane dhe asaj të krishterë. Gjatë periudhës së pandemisë, këto ambiente nuk kanë qenë të hapura, për shkak të urdhërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, por nga momenti i uljes së rrezikut të infeksionit të sëmundjes COVID-19 ata kishin filluar të jenë funksionale.

Aktivitetet e personave me masë mjekësore

Salla në godinën nr.5, për efikasitetin dhe realizimin e mirëfilltë të programeve individuale trajtuese është përshtatur për realizimin e terapisë së artit ku angazhohen rreth 5 shtetas me masë mjekësore dhe një shtetas i dënuar në një hark kohor rreth 3 orë gjatë orarit të veprimtimit në regjimin e brendshëm të Sektorit të Çështjeve Shoqërore (09⁰⁰-13⁰⁰).

Pas bashkëbisedimeve dhe marrëveshjes së arritur me Drejtorinë e Formimit Profesional Publik Shkodër pritet brenda muajit mars fillimi i kurseve profesionale për shtetasit me masë mjekësore, kryesisht në kursin e berberit dhe në kursin e hoteleri – turizmit. Për realizimin dhe zhvillimin e këtyre kurseve është përshtatur njëri krah i sallës në godinën nr.5. Gjithashtu në ambientet e godinës organizohen aktivitete festive duke organizuar koktejlle, lojëra argëtuese dhe aktivitete sportive.

Sektori i çështjeve shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t'iu ardhur në ndihmë personave që janë braktisur nga familjarët ose vijnë nga familje me nivel shumë të ulët social- ekonomik.

Funksionimi i veprimtarive ditore dhe programeve të tjera rehabilituese, si dhe angazhimi i plotë i shtetasve me masë mjekësore bëhet i mundur edhe si rezultat i ambienteve të ngrohta pas rregullimit dhe mbarëvajtjes së sistemit të kaldajave dhe garantimin e kushteve higjieno-sanitare për përkujdesje vetjake.

Në kuadër të ruajtjes së higjienës, sektori i çështjeve shoqërore punon edhe në motivimin dhe edukimin e mënyrës së ruajtjes së higjienës vetjake dhe jo vetëm, si pjesë e programit terapeutik okupacional.

Pavarësisht situatës, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit nuk duhet të ndërpritet, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe të të paraburgosurve dhe të dënuarve, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri dhe i dënuari, veprën penale, si dhe faktorët e riskut. Ka nevojë të shtohet kapaciteti njerëzor dhe burimet financiare për të mundësuar zhvillimin e këtyre aktiviteteteve në këtë sektor.

Shërbimi shëndetësor

Organika e sektorit shëndetësor përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) punonjës prej të cilëve 2 mjekë, nga të cilët njëri me kohë të plotë dhe tjetri part-time, 1 (një) stomatolog, 1 (një) farmacist dhe 7 (shtatë) infermierë. Mjeku dhe stafi shëndetësor ishin të plotësuar sipas organikës dhe të punësuar me kohë të plotë, përveç njërit mjek me kohë part-time.

Shërbimi shëndetësor ndodhet në katin e parë të godinës në regjimin e brendshëm, në një ambient të veçantë ku ndodhet dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës. Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevatet dhe shtroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme. Lista e të sëmurëve përbëhet nga 46 të sëmurë kronik, 2 të sëmurë me diabet si dhe 16 persona të sëmurë të shëndetit mendor, të cilët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjeksore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Në një ambient më vete, jashtë godinës së banimit ndodhet Spitali i IEVP-së, në Shënkoll Lezhë, e cila përbëhet nga 3 dhoma. Në këto ambiente trajtoheshin, persona me probleme të shëndetit mendor. Kujdesi shëndetësor ofrohej nga personeli mjekësor i institucionit, ndërsa për nevoja të vizitave të mjekëve specialist, ata dërgoheshin në spitalin e burgjeve në Tiranë. Ambienti në tërësi kishin nevojë të mbahej pastër dhe të lyhej. Dhomat spitalore ishin të pajisura me krevat, dyshek, batanie, çarçaf por mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Gjithashtu, për larjen e trupit kishin ambiente të posaçme në fund të korridorit (2 dushe me ujë të ngrohtë), si dhe 2 tualete të përbashkëta, të cilin ishin funksionale për këtë qëllim. Në ditën e inspektimit ishin të shtruar, 4 persona që vuanin nga diabeti, tensioni etj. Në hyrje të

korridorit ishin 2 (dy) kabina telefonike, për të cilat të burgosurit kishin akses për oraret e komunikimit në çdo kohë me familjarët e tyre.

Grupi i inspektimit, konstatoi se institucioni ishte furnizuar rregullisht me ilaçe si për rastet urgjente, ashtu edhe për mjekimin e të sëmurëve kronikë. Furnizimi me ilaçe bëhej sipas skemës së rimbursimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe me ilaçe të siguruar nga fondi i veçantë në dispozicion të Institucionit. Nga ana e sektorit shëndetësor trajtoheshin me medikamentin “metadon” disa të sëmurë kronikë.

Nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se, si regjistri për vizitat e kryera nga stafi mjekësor i institucionit ashtu dhe regjistri i të sëmurëve kronikë për konsultat jashtë institucionit, ishte i plotë. Gjithashtu, në dhomën e mjekut ndodhej edhe “Libri për ekzaminimin e rasteve të keqtrajtimin dhe të dhunës”. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ishin plotësuar sipas rubrikave. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës. Në disa raste, për shkak të dinamikës së trasferimeve nga një institucion penitenciar në tjetrin, kishte vonesë në plotësimin e dokumenteve përkatëse për vazhdimin e procedurës së pajisjes me librezë shëndetësore.

Gjithashtu për sa parashtrua më lart, ritheksojmë se është e nevojshme dyfishimi i personelit shëndetësor dhe ndihmues, në funksion të mirëadministrimit dhe plotësimit të nevojave shëndetësore të pacientëve, por edhe për të siguruar higjienë më të mirë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar”.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin tërësor të godinës nr. 1 IEVP Shënkoll, Lezhë, për ta sjellë në kushte të përshtatshme banimi duke kryer riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lysterje të dhomave të të paraburgosurve.
2. Deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, të merren masa të menjëhershme, për miratimin sa më parë të strukturës organike të IEVP Lezhë, bazuar në një studim të qartë dhe konkret të kryer nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për të shtuar

kapacitetet e shërbimit mjekësor dhe shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore.

3. Marrjen e masave për shtimin e personelit shëndetësor me mjek të përgjithshëm, mjek psikiatër, mjek kardiolog, mjek laborant klinik biokimik, infermierë, sanitarë dhe kujdestarë për pacientë me masë mjekësore, si më poshtë vijon: sektori shëndetësor në seksionin e masave shëndetësore nga 18 personel shëndetësor aktual, të bëhet me 36 mjekë dhe infermierë Sansitarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 sanitarë; kujdestarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 kujdestarë.
4. Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë për gjetjen e hapësirave për hartimin e akteve nënligjore dhe administrative për kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në I EVP Lezhë në godinat 4 dhe 5 të kalojnë në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin/rikonstruksionin e godinave të banimit nr. 2 dhe nr. 3 të I EVP Shënkoll, Lezhë, për të bërë këto godina funksionale dhe për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze për të burgosurit, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare, në lidhje me sipërfaqen dhe hapësirën jetike për person.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6 m² për dhomat për një person dhe 4m² për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.
7. Marrjen e masave të nevojshme për hidroizolim të tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të paraburgosurve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për reduktimin e mbipopullimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Shënkoll, Lezhë.
9. Marrjen e masave për instalimin në godinën e të paraburgosurve të sistemit qëndror për ngrohje/ftohje, si dhe ndërprerjen e lidhjeve të kabllave të rezistencave elektrike që përdoren për ngrohje, pasi përbëjnë rrezik për jetën e të paraburgosurve.
10. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të paraburgosurit të pajisen me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale, rritjen e normative mujore për të plotësuar nevojat personale të tyre, (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar dhomat e tyre.
11. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen, me tavolina, stola, komodina sipas kushteve normale për jetesë në dhomat e veçimit dhe të observimit, me kushte

higjierno- sanitare të pastra dhe dezinfektim të shpeshtë të këtyre ambienteve në IEVP Shënkoll, Lezhë.

12. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e kushteve dhe plotësimin e dhomave të banimit të të paraburgosurve me orenditë e nevojshme shtesë, për mbajtjen e ushqimeve dhe sendeve personale.
13. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së ushqimit dhe larminë e tij sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
14. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e urdhërit të Përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për normën dhe kuotën ditore të ushqimit të të burgosurve, duke ju përgjigjur kërkesave dhe nevojave të kohës.
15. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin sipas parashikimeve në organikën të IEVP Shënkoll, Lezhë, konkretisht, pozicionin e drejtorit, zv.drejtorit, të përgjegjësit dhe specialistit burimeve njerëzore, si dhe një mjekut me kohë të plotë, 2 (dy) specialistëve/jurist, 1(një) elektromekaniku, 1 (një) sek/prot/arshivisti, dhe plotësimin e sektorit të policisë, me 4 (katër) punonjës në rolin bazë dhe 1 (një) specialist, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas në këtë institucion.
16. Marrjen e masave të menjëhershme për rritjen e pranisë të punonjësve të sektorit juridik dhe sektorit psiko-social në kontakte të përditëshme me personat që vuajnë dënimin në këtë institucion, për dhënien e këshillimeve ligjore dhe sqarimet për zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave që ata mund të paraqesin.
17. Marrjen e masave të nevojshme për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, duke iu përshtatur nevojave të tyre, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këto kategori.
18. Marrjen e masave për rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale nga sektori psiko-social, me pjesëmarrjen e gjerë të personave të burgosur, të cilat ndikojnë në formimin dhe riintegrimin e këtyre personave, duke garantuar edhe buxhetin përkatës për to.
19. Marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen dhe pajisjen e ambienteve/dhomave të prindërimit me orenditë e nevojshme, me qëllim realizimin e takimeve fizike të paraburgosurve/ burgosurve me fëmijët e tyre, në kuadër të ushtrimit të drejtës së prindërimit në distancë.
20. Marrjen e masave të nevojshme për eliminimin të plotë të lagështirës në ambientet e kuzhinës, si dhe blerjen e pajisjes për aspirimin dhe ventilimin e ajrit, si dhe lyerja dhe mbajtja pastër e këtyre ambienteve në IEVP Shënkoll.
21. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, riintegrimi, si edhe aktivitete edukative e social-

kulturore-sportive, në bashkëpunim dhe me organizatat jofitimprurëse duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në këtë institucion.

22. Marrjen e masave të nevojshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marreveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
23. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e godinave nr.4 dhe nr.5 me të gjithë infrastrukturën dhe bazën e nevojshme mjekësore për trajtimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar”.
24. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien e tyre në punë, si dhe zgjatjen e kohës së telefonatave të paraburgosurve/ të burgosurve me familjarët dhe të afërmit e tyre dhe komunikimin me Avokatin e Popullit.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit **30 ditor** sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI